

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
DAPARTAMENTI CIVIL
PROGRAMI: E DREJTA CIVILE DHE PRONËSORE**



**PUNIM I DIPLOMËS MASTER
“RECIPROCITETI DHE RETORSINOI NË TË
DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE –
ANALIZË E RASTEVE NGA REPUBLIKA E
KOSOVËS”**

Mentori:

Prof. Dr. Hajredin Kuçi

Kandidati:

Safet Salihu

Prishtinë, Shkurt 2024

Abstrakti

Ky punim shkencor synon të analizojë përdorimin e reciprocitetit dhe retrosionit në të drejtën ndërkombëtare private, duke u fokusuar veçanërisht në rastet nga Republika e Kosovës. Reciprociteti dhe retrosioni janë dy koncepte juridike që kanë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe në përcaktimin e marrëdhënieve private mes shteteve.

Në këtë punim shkencor, do të analizohen rastet specifike ku reciprociteti dhe retrosioni janë aplikuar në praktikën e të drejtës ndërkombëtare private në Kosovë. Një shqyrtim i hollësishëm i këtyre rasteve do të na lejojë të kuptojmë se si reciprociteti dhe retrosioni janë zbatuar në praktikë dhe se si kanë ndikuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore. Në këtë analizë, do të merret parasysh konteksti juridik dhe institucional i Kosovës, si dhe marrëdhënia e saj me shtetet tjera në kuadër të drejtës ndërkombëtare private. Gjithashtu, do të shqyrtohen rregullat e aplikueshme, marrëveshjet ndërkombëtare dhe rasti jurisprudencial për të zbuluar përdorimin e reciprocitetit dhe retrosionit në Kosovë. Përfundimet e kësaj analize do të ndihmojnë në kuptimin e mëtejshëm të përdorimit të këtyre koncepteve dhe do të ofrojnë udhërrëfyes për praktikën dhe zbatimin e tyre në raste të tjera ndërkombëtare. Puna fillon me një shqyrtim të parimeve të reciprocitetit dhe retrosionit, duke përfshirë definicionet, natyrën e tyre dhe mënyrat e aplikimit në praktikën ndërkombëtare. Në vijim, analizohet konteksti ligjor dhe institucional i të drejtës ndërkombëtare private në Republikën e Kosovës, duke u përqendruar në marrëdhënien e saj me konventat dhe organizmat ndërkombëtare. Një aspekt kyç i punës është analiza e rasteve konkrete në të cilat është aplikuar reciprociteti dhe retrosioni në Republikën e Kosovës. Këto raste do të përfshijnë situata të ndryshme, siç janë çështjet e pronësisë, familjare, tregtare, dhe të tjera. Për secilën rast, do të shqyrtohen detajet e vendimit gjyqësor ose vendimeve dhe mënyrat se si është zbatuar parimi i reciprocitetit ose retrosionit.

Në fund të punës, përpilohet një analizë e përgjithshme e përfitimeve dhe sfidave të përdorimit të këtyre parimeve në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare private në Kosovë. Rezultatet e kësaj analize do të ndihmojnë profesionistët e ligjit, akademikët dhe institucionet qeveritare të kuptojnë më mirë përdorimin dhe rëndësinë e reciprocitetit dhe retrosionit si mjete të menaxhimit të çështjeve ndërkombëtare private në këtë vend.

Fjalë kyçe: Reciprocitet, Retrosion, Vendimet e huaja Gjyqësore, Republika e Kosovës, elementet e huaja.